



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:127284

Datë: 29.10.2024

Numri i dokumentit: 06366081

C.nr.2050/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me pjesëmarrjen e praktikantës gjyqësore D.O. në çështjen kontestimore të paditëseve Y.Sh., M.B., A.A., A.Ç., V.S. nga Prizreni që të gjithë punonjës në Q.B.M. dhe Këshillim në Prizren, të cilën sipas autorizimit i përfaqëson V. H. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës M.A.Sh.T. dhe Inovacionit - Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetore me seli në Prishtinë, vlera e kontestit 3420,00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 28.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Y.Sh., M.B., A.A., A.Ç., V.S.

II. DETYROHET e paditura M.A.Sh.T. dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, që në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit të ia kompensoj paditësve dhe atë:

- Për paditësin Y.Sh.

Për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2019, në shumën prej 86,75euro;

Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11,016 euro;

Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 187,27 euro

Për periudhën kohore Janar - Prill 2022, në shumën prej 212,97 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 497.94 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.06.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësin M.B.

Për periudhën kohore Qershor- - Dhjetor 2019, në shumën prej 43.91 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 5.52 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 94.80 euro;
Për periudhën kohore Janar - Prill 2022, në shumën prej 107,82euro;

Në shumën e përgjithshme prej 252.05 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.06.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësin A.A.

Për periudhën kohore Qershor- - Dhjetor 2019, në shumën prej 43.91 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 5.52 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 94.80 euro;
Për periudhën kohore Janar - Prill 2022, në shumën prej 107,82euro;

Në shumën e përgjithshme prej 252.05 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.06.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësen A.Ç.

Për periudhën kohore Qershor- - Dhjetor 2019, në shumën prej 65.97euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 8.37 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 142,41 euro
Për periudhën kohore Janar - Prill 2022, në shumën prej 161,95 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 378,70 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.06.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Për paditësen V.S.

Për periudhën kohore Qershor- - Dhjetor 2019, në shumën prej 82,02 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.41 euro;
Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 177.0 euro
Për periudhën kohore Janar - Prill 2022, në shumën prej 201.37 euro;

Në shumën e përgjithshme prej 470,8 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.06.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, me seli në Prishtinë, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve të ia paguaj shumën prej 342 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve: M.B. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 497.94 euro, përkatësisht shuma prej 245,89 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit; A.A. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 497.94 euro, përkatësisht shuma prej 245,89 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, A.Ç. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 497.94 euro, përkatësisht shuma prej 119.24 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si dhe V.S. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 497.94 euro, përkatësisht shuma prej 27,14 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësit Y.Sh., M.B., A.A., A.Ç., V.S. nga Prizreni të cilin sipas autorizimit i përfaqëson; Av. V.H. avokatë nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 21.06.2022 kanë ushtruar padi kundër të paditurës M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, në Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësit janë është në marrëdhënie pune pranë Q.B.M.K. në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore nga muaji prill 2017 deri në muajin dhjetor 2021 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2017 në 1.5%, për vitin 2018 në 1.1%, për vitin 2019 në 2.7%, për vitin 2020 në 0.2%, 2021 në 3.4% në pagën e kërkuar për paditësin Y.Sh. në lartësi prej 793.00 në pagën e kërkuar për paditësin M.B. në lartësi prej 359.00 euro, për paditësin A.A. në lartësi prej 378.00 euro, për paditësen A.Ç. në lartësi prej 488.00 euro, dhe për paditësin V.S. në lartësi prej 664.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, e cila llogaritet nga data 17.04.2017 e deri në pagesën definitive. I autorizuari i palëve paditëse av. V.H. pranë kësaj gjykate ka dorëzuar edhe parasshtresën e datës 30.07.2024, me të cilën ka precizuar kërkesëpadinë e palëve paditëse, ku ka kërkuar që të njëjtëve të iu bëhet kompesnimi i pagesës së përqindjes së inflacionit në pagë dhe atë për periudhën kohore prej 01 qershor 2019 deri me 30 prill 2022.

E paditura M.A.Sh.T. së Republikës së Kosovës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 15.12.2022 ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Ka theksuar se nuk është kontestuese fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe gëzojnë të drejtat nga marrëdhënia e punës. Kërkespadija e paditësve është mbështetur në Kontratën Kolektive për Arsim Nr.2056 e vitit 2017. E paditura vëlerëson se anjë dipozitë kjo kontratë nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte gjegjësisht kompensimin e pagesës së përqinfjes (%) së inflacionit në pagë, me arsyetimin se Kontrata Sektoriale e Arsimit në Kosovë Nr. 01B/2056 është lidhur me dt.18.04.2017 për tri vite dhe atë deri me dt.18.01.2020 që dmth se kanë kaluar tri vite nga nëshkrimi i saj, e më këtë ka pëfunduar edhe vlefshmëria e saj. Më saktësisht Kontrata Sektoriale për Arsim, ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 e deri me dt.18.04.2020 duke bërë kështu që kërkespadija së paditësve për periudhën prill 2017 e deri në prill 2020 ti mungojë baza ligjore, pasi që me asnjë dipozitë të kësaj kontrate nuk parashihet të ketë veprim retroaktiv, për realizimin e kësaj të drejte dhe se me kalimin e afatit për të cilën është lidhur kjo marrëveshje skadon edhe afati i implementimit të saj duke bërë kështu që paditësve t'iu kalojë afati brenda së cilës kanë mundur të kërkojnë reaalizimin e kësaj të drejte. Ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkespadija për periudhën 22 janar 2021 (koha kur është lidhur KONtrata Sektoriale e vitit 2021) e der me dt.21.11.2022 (koha kur është shkëputur kjo kontratë), nuk kanë ekzistuar mundësitë institucionale - financare për realizimin e kësaj të drejte. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkespadija e paditësës është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës datës 01.05.2014 për paditësin Y.Sh. e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi në periudhën kohore prej 02.05.2014 deri me datë 30.04.2008 si Drejtor në Qendrën Burimore "Nënë Tereza" dhe nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 511.88 euro. Nga Kontrata e punës datës me Nr.prot.3/1048-65 e datës 02.03.2016 për paditësin M.B.e lëshuar nga Ministria e

Arsimite Shkencës dhe Teknologjisë në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi nga data 01.09.2015 është në marrëdhënie pune tek e paditura si puntor teknik ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 232.38 euro. Nga Kontrata e punës datës me Nr.prot. 3/1048-81 e datës 02.03.2016 për paditësin A.A. e

lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi nga data 01.09.2015 është në marrëdhënie pune tek e paditura si puntor teknik ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 232.38 euro. Nga Kontrata e punës datës me Nr.prot. 3/1048-81 e datës 02.03.2016 për paditësin A.A. e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi nga data 01.09.2015 është në marrëdhënie pune tek e paditura si puntor teknik ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 232.38 euro. Nga Kontrata e punës datës me Nr.prot. 3/1048-80 e datës 02.03.2016 për paditësen A.Ç. e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi nga data 01.09.2015 është në marrëdhënie pune tek e paditura si Moter Edukatore ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 335.63 euro. Nga Kontrata e punës datës me Nr.prot. 3/1048-59 e datës 02.03.2016 për paditësin V.S. e lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi nga data 01.09.2015 është në marrëdhënie pune tek e paditura si Mësimdhënës i Matematikës nga ky raport kontraktual merr pagën bazë në lartësi prej 417.41 euro.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartëcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve Y.Sh., M.B., A.A., A.Ç., V.S. ju takon e drejta në pagesën mbi

bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për paditësin Y.Sh.

Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 459 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 86,75 euro ($459 \times 2.7\% = 12.39 \times 7 = 86,75$ euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2020 ka qenë 459, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 11.016 euro ($459 \times 0.2\% = 0.91 \times 12 \text{ muaj} = 11.016 \text{ euro}$).

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2021 ka qenë 459, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 187.27 euro ($459 \times 3.4\% = 15.60 \times 12 \text{ muaj} = 187.27$ euro).

Për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2022 ka qenë 459, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 212.97 euro ($459 \times 11.6\% = 53.24 \times 4 \text{ muaj} = 212.97 \text{ euro}$).

Për paditësen M.B.

Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 232.38 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 50.19 euro ($232.38 \times 2.7\% = 6.27 \times 7 = 43.91 \text{ euro}$).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2020 ka qenë 232.38, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 5.52 euro ($232.38 \times 0.2\% = 0.46 \times 12 \text{ muaj} = 5.52$ euro).

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2021 ka qenë 232.38, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 94.82 euro ($232.38 \times 3.4\% = 7.90 \times 12$ muaj = 94.82 euro).

Për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2022 ka qenë 232.38, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 107.82 euro ($232.38 \times 11.6\% = 26.95 \times 4$ muaj = 107.82 euro).

Për paditësin A.A.

Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 232.38 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 50.19 euro ($232.38 \times 2.7\% = 6.27 \times 7 = 43.91$ euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2020 ka qenë 232.38, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 5.52 euro ($232.38 \times 0.2\% = 0.46 \times 12$ muaj = 5.52 euro).

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2021 ka qenë 232.38, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 94.82 euro ($232.38 \times 3.4\% = 7.90 \times 12$ muaj = 94.82 euro).

Për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2022 ka qenë 232.38, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 107.82 euro ($232.38 \times 11.6\% = 26.95 \times 4$ muaj = 107.82 euro).

● Për paditësen A.Ç.

Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 335.63 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të

futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 65.97 euro ($335.63 \times 2.7\% = 9.4 \times 7 = 65.97$ euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2020 ka qenë 335.63, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 8.37 euro ($335.63 \times 0.2\% = 0.69 \times 12 \text{ muaj} = 8.37$ euro).

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2021 ka qenë 335.63, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 142.41 euro ($335.63 \times 3.4\% = 11.86 \times 12 \text{ muaj} = 142.41$ euro).

Për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2022 ka qenë 335.63, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 161.90 euro ($335.63 \times 11.6\% = 40.48 \times 4 \text{ muaj} = 161.90$ euro).

- Për paditësen V.S.

Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2019 ka qenë 434 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 82.02 euro ($417.41 \times 2.7\% = 11.70 \times 7 = 82.02$ euro).

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2020 ka qenë 434, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 10.41 euro ($434 \times 0.2\% = 0.86 \times 12 \text{ muaj} = 10.41$ euro).

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2021 ka qenë 434, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 177.0 euro ($434 \times 3.4\% = 14.75 \times 12 \text{ muaj} = 177.0$ euro).

Për periudhën 01.01.2022 - 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësi në vitin 2022 ka qenë 434, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është në shumën prej 201.37 euro ($417.41 \times 11.6\% = 50.34 \times 4 \text{ muaj} = 201.37$ euro).

Gjykata vendosi që palëve paditëse M.B., A.A., A.Ç., V.S. të refuzojë pjesëtisht kërkesën e tyre, ngase të njëjtit kanë kërkuar që të iu bëhet kompensimi i pagesës së inflacionit në pagën bazë, ku si pagë bazë kanë kërkuar shumën prej 459 euro, ndërsa nga provat e paraqitura nga vetë palët paditëse, më saktësisht nga lista e pagave është vërtetuar fakti se të njëjtit nuk parnojnë pagën bazë sipas kërkesës por paditësi M.B. pranon pagën bazë mujore prej 232.38euro, po ashtu të njëjtën pagë bazë e ka edhe paditësi A.A. ndërsa pasitësja A.Ç. ka pagën bazë prej 349,05 euro, dhe paditësi V.S. ka pagën bazë në lartësi prej 434.05 euro. Andaj mbi këtë bazë gjykata ka vendosur si në pikën IV të këtij aktgjykimi duke ia refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve të përmendur në këtë paragraf.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (17.05.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 332 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2050/2022, datë 28.10.2024

G j y q t a r i
Shyqri Hoxha

Numri i lëndës: 2022:127284
Datë: 29.10.2024
Numri i dokumentit: 06366081

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.